


TAHIR JAHA – EMËR, QË NUK HARROHET (1913 – 2003)



Tahir Jaha, njeriu i empatisë

Shkruan: Mr.Sc.Shefki Stublla

Tahir Jaha me dinjitetin dhe modestinë e tij ishte i dashur në familje dhe në shoqëri, si njeri dhe si letrar. Koincidenca domethënëse e përmbajtjes së emrit dhe mbiemrit të tij përputhet me shpirtin „jetën dhe veprën e tij: emri Tahir, ar.- i pastër; Jaha, ar. – i gjallë. Andaj, mund të thuhet se Tahir Jaha të gjitha stinët e jetës së tij i vendosi sipas kësaj përmbajtjeje jetësore të emrit dhe mbiemrit të tij. Dhe, me plot gojën, mund të thuhet se ky njeri kishte energji pozitive, ishte njeri serioz, i ndershëm në punë dhe i mrekullueshëm në të gjitha kohët e mënyrës dëftore të foljes “ *me qenë* “. Si fjalët i kishte punët. Ishte aktor i bindjes aktive bamirëse dhe i historisë së humanizmit në Kosovë. Kurrë veta e dytë dhe e tretë e përemrit vetor, në veprimtarinë e tij, nuk zëvendësohej me veten e parë, kur është fjala për ndonjë përfitim personal. Përherë koha e kaluar zëvendësohej me veten e parë në veprim. Personazhet e tij, ishin si vetja e tij, që përherë u gjente një zgjidhje, e cila lexuesin nuk e lë të varur.

Ja kush është Tahir Jaha, në pak fakte biografike

Tahir Jaha lindi më 13 mars 1913, në fshatin Babaj Bokës, afër Gjakovës. Në një familje ta varfër fshatare. Shkollën fillore e kreu në Krumë (Shqipëri), në vitin 1925 dhe për një kohë vazhdoi mësimet në Gjimnazin e Shkodrës, por mësimet i ndërpreu, për shkak të gjendjes së vështirë

ekonomike. Për të siguruar kafshatën e gojës iu desh të punojë. Më vonë e kryen shkollën e mesme.

Në vitin 1942 kthehet në Kosovë dhe merr pjesë aktive në LNÇI. Pas çlirimit, në Prizren, në vitin 1944 ishte komisar i Komandës së Vendit dhe i Komandës së Qarkut të Prizrenit. Në vitin 1947/48, sekretar Komitetit të Rrethit në Dragash.

Nga viti 1948 – 1950 ishte epror i shëndetësisë dhe asistencës sociale të Këshillit Popullor të Kosovës.

Nga viti 1951 – 1956 ishte drejtor i Shtypshkronjës “Miladin Popoviq” në Prishtinë. Si drejtor i kësaj ndërmarrjeje bëri përpjekje të vetëmohuese për mëkëmbjen e kuadrit profesional, ndërtimin e godinës dhe pajisjeve teknike të shtypshkronjës, duke i dhënë kontribut të çmueshëm zhvillimit të shtypit në Kosovë, duke përfshi këtu edhe gazetën “Rilindja” me të gjitha redaksitë e saj të veprimtarisë botuese në gjuhën shqipe. Për këtë kontribut të pashoq ndoq sintagmën: *në kullën e shtypit dielli lind më herët.*

Nga viti 1960 – 1982 kalon në detyrë në Kryqin e Kuq të Kosovës ku ushtron detyrën e sekretarit dhe më vonë edhe të kryetarit të kësaj shoqate bamirëse deri në pensionimin e tij. Për këtë organizatë humanitare të Kosovës, ishte si Anri Dinan, (Henri Dunant), themeluesi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar me seli në Zvicër. Në shenjë nderimi e respekti për veprimtarinë e tij të sinqertë dhe të dobishme të Shoqatës së Kryqit të Kuq të Kosovës, ai shpallet kryetar nderi i kësaj Shoqate. Po ashtu ,në shenjë respekti ndaj tij, në hollin e godinës, ku vepron kjo shoqatë, ndodhet busti i figurës së tij bashkë me bibliotekën e tij personale, të cilën e dhuroi familja e tij si **legat**.

Tahir Jaha, kudo që veproi, punën e kreu me nder dhe përmendet për të mirë. Ishte zotëri i vërtetë, simbol i gjallë i së mirës. Në veprimtarinë e tij ndoqi metodën demokratike, kishte një liri shpirtërore me një frymë liberale, për dallim nga disa prijës të asaj kohe që “punët i rregullonin me stupc në krah”. Ishte kundër sundimit tiranik, kudo. Në familje dhe në shoqëri.

Në kohën e veprimtarisë së tij shoqërore, në Kosovë, u shtrua nevoja për shfrytëzimin e energjisë elektrike dhe të resurseve tjera . Ishte koha e një konceptioni të ri për kalimin nga një e trajtë e jetës në tjetrën, për të dalë nga vilajeti i territ në të cilën gjendej Kosova pas LDB. Fjala ndryshim e përshkon veprimtarinë e Bacës Tahir. Është kjo koha e një filozofie të re, me petk të ri shoqëror, duke mos pritur meqenëse Baca Tahir besonte që punëtori kosovar duhet të jetë bartës i ndryshimit.

Tahir Jaha, me shembullin e vet, porositi, me gojë e me shkrim: jo vetëm të *tregosh* por edhe të *dëshmosh*, jo vetëm të *shikosh*, por edhe të *shohësh*, jo vetëm të *dëgjosh*, por edhe të *ndjesh*. E tërë kjo për të dalluar “*pohoren*” nga “*mohorja*”, për të dalë nga vilajeti i territ shekuj me radhë që sollën pushtuesit e huaj.

Veprimtaria letrare e Tahir Jahës

Krahas punës shoqërore e bamirëse, Tahir Jaha, merret edhe me krijimtari letrare si disiplinë të komunikimit me lexuesin. Temat e shtjellimit letrar ishin bashkëkohëse të jetës së tij. Shkroi veprat e veta në tri gjini letrare: në poezi, prozë dhe dramë, ku e paraqiti jetën nga pikëvështrimi i vet bamirës. Portretoi letrarisht jetën e mesit tonë duke bartur në letër ndjenjat dhe duke trajtuar ato me një qasje origjinale. Kryefjala e veprave të Tahir Jahës është *empatia* ndaj njeriut, dmth., kur njeriu e ndjen atë që e mundon tjetrin. Ndjenjën e empatisë e kishte thithur nga gjiri i nënës së vet, që është tipari më i mirë cilësisë së njeriut, që lidhet me bamirësinë si burim i ndjeshmërisë ndaj tjetrit dhe i altruizmit dhe devotshmërisë. Mësimet e para gojore i mori nga babai i tij që i mishëroi më vonë në praktikën jetësore, për dashurinë e nënës, për krenarinë e babait, i prirur kah liria dhe pavarësia kombëtare, duke nxituar, siç thoshte Tahir Jaha: "ngutu, ngadalë".

E vërteta letrare e Tahir Jahës dallohet nga e vërteta letrare Beogradit, e cila dhunshëm interpreton të vërtetën për Kosovën, duke i ofruar botës të vërteta të gjymta për shqiptarët dhe për jetën e tyre. Të vërtetën për Kosovën Tahir Jaha e prezanton në monolog, dialog dhe në interpretim të lirë, me porosinë që të mos e ulim kokën dhe të turpërohemi para askujt, kur është në pyetje historia dhe trashëgimia jonë. Sepse me të vërtetën për Kosovën u manipulua dhe, për fat të keq, ende manipulohet.

Veprimtaria letrare e Tahir Jahës fillon me vjershat "Zani i kushtrimit" dhe "Me dy teha" (1943), "Ereniku" (1944), poema "Çlirimtarët" (1943-1944), fragmenti "Tymon oxhaku i Sadik Micanit" (1964), të botuara në revistën letrare "Jeta e re", "Zani i rinisë", "Rilindja" dhe në "Gjurmët e përflakura" të Isak Shemës.

Tahir Jaha për veprat e veta u inspirua nga rrethi ku lindi, jetoi dhe veproi. Ideja themelore e veprave të tij është vënia e të mbarës në binarët e shëndoshë të jetës. Personazhet e tij janë të karakterizuara qartë, me veprime të arsyeshme.

Veprat letrare, të botuara nga revista letrare "Jeta e re", në vitin 1998, janë: "Sofra micaniane", "Në kullën e shtypit, Dielli lind më herët", "Përsëritje të përdhembshme", "Eja - eja", "Dialog kohe", "Lulet e stinëve", "Tymon oxhaku i Sadik Micanit".

Prejardhja e veprave të Tahir Jahës është nga jeta reale e një etologjie të zakoneve dhe formave të sjelljes së njerëzve brenda kombit, që lidhen me tiparet e karakterit të pjesëtarëve të tij dhe janë pjesë e regjistrit të temave që trajton ky shkrimtar, duke mos iu shmangur kurrë

rrugës së atdhedashurisë që ilustron me oxhakun e Sadik Micanit, i cili tymoi dhe tymon në truallin e vet, ku prushi i atdhedashurisë nuk shuhet kurrë.

Mendoj tërë veprimtaria letrare e Tahir Jahës mund të përmblihet në sintagmën: *Sofra micaniane*, në të cilën janë shtruar ndenjuri për t'u lexuar veprat e tij. Nga vetë titujt e veprave kuptohet se bëhet fjalë për formimin e botëkuptimit të drejtë ndaj problemeve jetësore e jo për kurrfarë testamenti politik. Veprat e tij i përkasin një fushe të krijimtarisë letrare që ka adresën e identitetit të njerëzimit të njeriut, si refleks në evitimin e të këqijave nga jeta, sidomos kundër dembelisë, me porosinë "puno mirë, kudo që je i angazhuar", "kush e ka ndërgjegjen e pastër ditën, nuk frikësohet natën", etj.

Veprat e tij janë prodhim i një kohe kur Kosova po dilte nga terri shumëshekullor i dijes, i luftës kundër analfabetizimit, kur po krijoheshin kushtet dhe mjetet për të shkruar shqip, për botimin e veprave letrare shqip, për krijimin e një jete institucionale, kulturo-arsimore, kur po krijoheshin kushtet për emancipimin e femrës shqiptare.

Ngjarjet për të cilat shkruan Tahir Jaha janë origjinale dhe nuk kanë nevojë për *azil*, sepse të gjitha personazhet e veprave të tij, ndodhin e jetojnë në vendin e vet *den baba den*. I përgjigjen temës pa kurrfarë qëllimi për të ikur nga atdheu. Sepse, Tahir Jaha nuk merret me cinikët e jetës as me thartimin saj. Ndershmëria dhe humanizmi janë sinonim i veprës së tij, i cili, fjalën para se ta shkruajë, e mendon tetë herë duke e vënë atë në sitën e hollë e të menduarit. E tërë kjo, këtë krijues nuk e vë në ballë të interesimit si një kujdestar politik, me shumë gajle, por si një pjesë të zgjuar të popullit për vendosjen e marrëdhënieve të drejta në shoqëri për prodhime të mirëfillta, në të gjitha fushat e jetës.

Tahir Jaha me lapsin e tij kërkon me këmbëngulje të bëhet diçka e re, unike, me punë, me djersë dhe për paqe. Personazhet e tij janë njerëz të gjallë që jetojnë dhe, secili nga ta, ka karakterin e vet moral dhe etik. Kur njeriu lexon ose dëgjon fjalët e personazheve të veprës, ka përshtypjen se dëgjon zërin e autorit, me porosi për energji pozitive.

Jetë në kohën që mbulohet me domethënie që duhet t'i zbulojë vetë njeriu, që për secilën nga to, njeriu duhet ta marrë përgjegjësinë e së vërtetës, e cila ka rëndësi për të gjithë.

Gjuha, stili dhe fjalori që përdor autori, është i qartë, i pasur, origjinal, herë-herë i ilustruar me fjalë të leksikut popullor shqip, që dëshmojnë kohën e kaluar, ku gjithmonë në tekst e ke fjalinë e plotë, ku dallohet qartë kryefjala dhe kallëzuesi i ngjarjes. Mund të thuhet se ky autor është një lloj *gjeometri* i gjuhës së jetës. Po theksoj: asnjë personazh i këtij autori, kur flet ose punon, nuk krijon panik, nuk shkakton frikë, por përpiqet për të krijuar marrëdhënie të mira ndërmjet njerëzve, pa grindje dhe pa armiqësi. Nuk ka përbuzje për as kë, në tekstin e veprave të tij për. Nuk ka demoralizim. Porosia e tij është: *shikojeni botën përmes syve tuaj*. Thëniet dhe mendimet shfaqen *pa dorëza* edhe kur flet për gjëra të "vogla" dhe për gjërat "e mëdha." Veprat e tij nuk kanë *mimikri*. Asnjë personazh i tij nuk bëhet pion i askujt. Secili ka unën e vet.

Përmbajtja e veprave të tij paraqet një kimi të jetës reale të një procesi zhvillimor,të mbushur me oksigjen...

Përfundim

Tahir Jaha ishte njeri,i cili në çdo vend ku punoi e ruajti ekuilibrin e shkathtësisë njerëzore. Që veproi dhe mendoi në mënyrë të matur,të peshuar e pa lëkundje.I cili me gojë dhe me shkrim gjente mënyrën adekuate të komunikimit.Ishte njeri i empatisë.Që jetoi ndershëm me vetëmohim.Kurrë nuk e ofendoi as kë,nuk u hakmuar për të zënë ndonjë pozitë në shoqëri . Gjatë jetës është ndër të rrallët që nuk mori honorar për punë jashtë orarit të punëas as mëditje nga udhëtimet zyrtare.Nuk jetoi veresie as koturu.

Opusin letrar të Tahir Jahës e karakterizon një vlerë imanente letrare që burim ka historinë e institucionalizimit të veprimtarisë letrare në Kosovë,me një qasje të veçantë si argument të konstruktit letrar të identiteteve pa kurrëfarë tipi mitologjie.Vepra e tij letrare është një memorie e ditëve të para,pas LDB, kur fillon shkrimi letrar shqip në Kosovë,me ç’rast ai paraqet shumë inserte nga jeta:në kullën e shtypit,në sofrën micaniane,përshtypje të përdhembshme, në dialog kohe,në lulet e stinëve,në oxhakun e Sadik Micanit,në trajtën *vitae* dhe *mentis,pa presimizëm*, duke inspiruar shkrimtarët e rinj,që të mos e harrojnë traditën,sepse në këtë botë çdo gjë ushqehet nga rrënjët.

E kam vështirë, në fund të këtij shkrimi, të gjej fjalë adekuate,për të paraqitur madhështinë e Bacit Tahir, këtij punëtori dhe krijuesi të mrekullueshëm letrar.